



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes për Hapjen e Pikës së Re Kufitare të Përbashkët për Udhëtim Rrugor Ndërkombëtar në mes dy vendeve Stançiq-Belanoc, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, të nënshkruar në Gllloboçicë me 24 qershor 2013 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 06 gusht 2013.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-017-2013.

Prishtinë, më 18 shtator 2013.



Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës



MARËVESHJE

MES

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**PËR HAPJEN E PIKËS SË RE KUFITARE TË PËRBASHKËT PËR UDHËTIM
RRUGOR NDËRKOMBËTAR NË MES DY VENDEVE
" STANÇIQ- BELANOCË "**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës Maqedonisë në tekstin e më tutjeshëm " Palë Kontraktuese".

Duke u nisur nga mardhëniet miqësore ,bashkpunimi dhe fqinjësia e mirë mes dy shteteve.

Të udhëhequra nga dëshira për krijimin e kushteve të volitshme për përforsim të mëtutjeshëdhe zhvillimin e bashkepunimit reciprok te dobishem

Duke u nisur nga qëllimi për realizimin e zgjedhjes për përmirësimin e Infrastrukturës transportuese ne Evropë dhe regjion si vërtetim në marveshjet veç se të arritura në nivele të larta politikekanë rënë dakord si në vijimë:

Neni 1

Palët kontraktuese në afat të caktuar ndërmjet autoriteteve kompetente, kanë rënë dakord për të ndërtuar dhe për të hapur një kalim të ri kufitar të përbashkët të dedikuar për transportin ndërkombëtar rrugor "Stançiq- Belanovcë" që lidh Stançiqin në teritorin e Republikës së Kosovës dhe Belanovcën në teritorin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 2

Secila nga Palët kontraktuese, në teritorin e vet do të ndërtojë, rikonstruktoj dhe modernizojë rrjet rrugor të arritshëm. Secila nga Palët kontraktuese, për funksionimin e pikes të përbashkët kufitare të dedikuar për transport ndërkombëtar rrugor do të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme për shërbim të të gjitha llojeve të ngarkesave dhe udhëtareve. Madhësia e objektit, standardet rreth lidhjeve rrugore të vendkalimeve kufitare do të jenë të harmonizuara në Komisionin e Miks të ekspertëve. (në tekstin në vijim si KME). Vendet e sakta të ndarjes së kufirit dhe vendodhja e saktë e vendkalimit të përbashkët kufitar të dedikuar për trafikun ndërkombëtar rrugor, si dhe parametrat teknik të tij do të jenë të përcaktuara nga KME).

Neni 3

Palët Kontraktuese do të krijojnë një KME, e cila do të vërtetojë karakteristikat themelore teknike të lidhjeve rrugore, vendndodhjen e rrugëve, pikat ndarëse me kufirin, vendin e vendkalimit të ri të përbashkët kufitar dedikuar për trafikun ndërkombëtar rrugor, infrastrukturën, objektet kontrolluese, llojet e ngarkesave dhe udhëtarëve, rregjimin e funksionimit, çështjet ligjore dhe normative rreth ndërtimit të vendkalimit të ri të përbashkët kufitar i dedikuar për trafikun ndërkombëtar rrugor dhe gjitha çështjet me interes të përbashkët të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

KME do të punojë dhe do të merr vendime në përputhshmëri me udhëzimet e Qeverive të të dy vendeve.

Palët kontrktuese u morën vesh që takimet e KME të mbahen të alternuara në Prishtinë dhe në Shkup.

Palët kontraktuese në afat prej 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në rrugë diplomatike të shkëmbejnë lista me emra dhe funksione të anëtarëve të KME të cilët gjatë muajit të ardhshëm pas shkëmbimit të listave do të mbajnë takimin e parë punues pas marrjes së njoftimit të tillë.

KME në takimin e parë punues do të harmonizojë tekstin e Rregulores së punës dhe në mbledhjen e radhës do të miratojë të njëjtën.

Neni 4

Për funksionimin e plotë të kufirit të ri të përbashkët të destinuar për transportin ndërkombëtar rrugor "Belanovcë - Stançiq" Palët kontraktuese mund të lidhin protokolle shtesë për çështjet për të cilat konsiderojnë që janë me rëndësi për zbatimin e dispozitave të përcaktuara me këtë Marrëveshjeje.

Neni 5

Mosmarrëveshjet rreth interpretimit dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen nga ana e KME-së. Nëse në afat prej tre (3) muajsh KME nuk mund të propozojë zgjedhje të pranueshme për të dy palët, mosmarrëveshjet do të zgjidhen me negociata ndërmjet dy Qeverive deri në fund të muajit ardhshëm.

Neni 6

Marrëveshja do të hyjë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të fundit me të cilën Palët kontraktuese përmes kanaleve diplomatike informojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore.

Nënshkruar në Gllloboçicë më 24.6.13 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe maqedonase, sërbe dhe angleze. Në rast të dallimeve në interpretimin e marrëveshjes, atëherë versioni në gjuhën angleze do të mbizotroj.


**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**


**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**
